



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Nr. 1094/prot.
2

Tiranë, më 20.5.2026

FTESË PËR OFERTË

“PRODHIMI I EMISIONEVE TË PULLËS PËR VITIN 2025”

Drejtorja e Përgjithshme “Posta Shqiptare” Sh.A., në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1039, datë 16.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave për emetimin prodhimin dhe tregtimin e pullës postare shqiptare”, i ndryshuar me VKM-në nr. 217, datë 13.04.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1039, datë 16.12.2015 të Këshillit të Ministrave, a) Neni 24 ndryshohet, si më poshtë vijon: “24. Pullat postare shqiptare shtypen në ente të specializuara, të pajisura me dokumentacionin e nevojshëm për shtypjen e letrave me vlerë, certifikatë cilësie dhe sigurie të shtypit”. Ju fton të paraqisni ofertën tuaj për realizimin e procedurës së prodhimit të pullës me objekt: “Prodhimi i emisioneve të pullave për Vitin 2025”, me fond limit 3,300,000 (tre milion e treqind mijë) lekë, pa TVSH.

Operatori duhet të plotësojë kriteret si më poshtë vijon:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Përcaktohen kriteret e kualifikimit si vijojnë:

Për të provuar kapacitetin ligjor, Kandidati duhet të dorëzojë:

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin që garohet, dhe ka statusin aktiv;
 - b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
 - c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale;

- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve ;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë dokumentacionin e siper përmendur.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

➤ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

“PRODHIMI I EMISIONEVE TË PULLËS PËR VITIN 2025”

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formulari i Ofertës;*
- b. *Sigurimi i ofertës, në masën 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;*
- c. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;*
- ç. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit;*
- e. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre vitet e fundit (2023, 2024, 2025), ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 39% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2023,2024,2025) nga

data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që garohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 8 (tetë). Për plotësimin e kësaj kërkesë, operatori ekonomik duhet të dorëzojë një vërtetim për numrin e punonjësve të lëshuar nga Administrata Tatimore që vërteton se subjekti ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për muajin e fundit të maturuar nisur nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me listëpagesën e dorëzuar pranë organeve tatimore për muajin e fundit të maturuar nisur nga data e hapjes së ofertave.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- makineri parapërgatitje CTP (linje e kompletuar –Computer to Plate);
- makinë printuese Offset me 5 ngjyra;
- **makineri birosje (perforimi) për pullën me krehra përkatës;**
- **Përkatësisht (30x40 mm, 34x44 mm, 44x34 mm, 43x31 mm, 40x40 mm, +-0.5mm)**
- pajisje Densiometër ngjyre për përcaktimin e ngjyrave
- Disponimi i makinerive të mësipërme të vërtetohet duke paraqitur fature blerje ose dokument zhdoganimi ose në rastin e marrjes me qira duhet paraqitur kontratë qiraje të noterizuar, etj.
- Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qarte të makinerive/ pajisjeve të kërkuara.

Sqarim! Përmasat e secilës pullë postare, janë të pasqyruara në DST, në Specifikimet teknike, Aneksi nr. 1: Skeda teknike e emisionit **Prodhimi i Emisioneve të Pullave për Vitin 2025**

2.3.4. Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm **për shtypjen e letrave me vlerë** referuar VKM-së Nr. 1039, datë 16.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave për emetimin prodhimin dhe tregtimin e pullës postare shqiptare”, i ndryshuar me VKM-në nr. 217, datë 13.04.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1039, datë 16.12.2015 të Këshillit të Ministrave.

2.3.5. Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm **certifikatë sigurie të shtypit** referuar VKM-së Nr. 1039, datë 16.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave për emetimin prodhimin dhe tregtimin e pullës postare shqiptare”, i ndryshuar me VKM-në nr. 217,

datë 13.04.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1039, datë 16.12.2015 të Këshillit të Ministrave.

2.3.6 Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm certifikatë cilësie referuar VKM-së Nr. 1039, datë 16.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave për emetimin prodhimin dhe tregtimin e pullës postare shqiptare”, i ndryshuar me VKM-në nr. 217, datë 13.04.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1039, datë 16.12.2015 të Këshillit të Ministrave.

2.3.7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të përcaktojë se disponon ambiente ku do të kryhen proceset e prodhimit të pullës të cilat duhet të jenë të monitoruara me kamera **24 orë** pa ndërprerje, gjatë gjithë kohës së prodhimit.

2.3.8. Operatori Ekonomik duhet të ketë ambiente të sigurta dhe të ruajtura për magazinimin e letrës dhe për produktet e gatshme të siguruara me kamera sigurie. Për këtë duhet të paraqesë certifikatë pronësie ose kontratë shitblerje ose kontratë dhurimi ose kontratë qiraje të ambientit, shoqëruar me dokumentacion pronësie të qiradhenësit.

2.3.9. Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letre pulle sipas specifikimeve/karakteristikave si më poshtë:

- a) **Pesha totale e letrës me gjithë elementët e saj të jetë minimumi 95 gr/m2 deri në 105 gr/m2 maksimumi.**
- b) **Bardhësia : minimumi 85 % deri në 95 % maksimumi.**
- c) **Letra e pullës të ketë fijet fosforeshente të dukshme vetëm nën ndriçimin e llampës UV.**
- d) **Letra e pullës postare të ketë bashkëngjitur skedën teknike të saj.**

2.3.10 Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion tabak letre pulle postare në formatin A3, të birosur, sipas një nga përmasave të pullave të kërkuara në Skedën Teknike (referojuni formatit në mm), pa foto. (çdo kampion i paraqitur dorazi të jetë qartësisht i dukshëm me firmë të perfaqësuesit dhe vulë të shoqërisë me qëllim shmangien e çdo konfuzioni).

2.3.11 Operatori Ekonomik në datën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë dorazi një kampion letër pulle postare të bllokut 1/a sipas Skedës Teknike, format 80 x 60 mm (në brendësi i birosur 40 x 30 mm), pa foto. (çdo kampion i paraqitur dorazi të jetë qartësisht i dukshëm me firmë të perfaqësuesit dhe vulë të shoqërisë me qëllim shmangien e çdo konfuzioni).

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributorit të autorizuar si dhe të dorëzojë skedë teknike të prodhuesit të letres së pullës postare në të cilën të pasqyrohen qarte të dhenat teknike sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

2.3.13 Së bashku me dokumentacionin e kërkuar në dokumentat standarte të procedurës, Operatori Ekonomik ofertues, duhet të dorëzojë si pjesë të ofertës, një deklaratë, ku deklarohet se: **“Përpara vlerësimit të ofertave, Operatori Ekonomik ofertues, është i gatshëm dhe pranon Komisionin e vlerësimit të ofertave si dhe personat e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithëshme “Posta Shqiptare” SH.A., për verifikimin në vend të ambjenteve dhe të pajisjeve të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit për gjendjen fizike të makinerive si dhe provën e tyre nga**

punonjësit e operatorit ofertues në prani të përfaqësuesve të autorizuar nga nga Drejtoria e Përgjithëshme "Posta Shqiptare" SH.A, për realizimin e "Prodhimi i Emisioneve Të Pullave Për Vitin 2025".

Drejtoria e Përgjithëshme "Posta Shqiptare" SH.A rezervon të drejtën që në çdo kohë pas nënshkrimit të kontratës dhe përpara fillimit të "Prodhimi i Emisioneve Të Pullave Për Vitin 2025" të bëjë verifikime pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave dhe/ose Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve dhe/ose prodhuesit për të vërtetuar funizimin me letrën e pullës të operatorit ekonomik.

Mos paraqitja e kësaj deklarate si dhe mospërmbushja në vend e deklaratës nga operatori ofertues, është kusht skualifikues.

Komisionit të vlerësimit të ofertave i lind e drejta që para shpalljes së klasifikimit të bejë verifikimin në vend të pajisjeve, të gjendjes teknike të tyre dhe ambientit të kërkuar sa më sipër. Në rast të mos përmbushjes në vend nga operatori ofertues, Komisionit i lind e drejta e s'kualifikimit të ofertuesit.

Shenim: Bocetet që do të prodhohen, janë të formatuara në CD dhe do të kenë korigjime teknike para futjes në prodhim. Ndersa shkrimi për Cirkularët dhe Albumet do të faqoset në shtypshkronjën e operatorit fitues.

Ky material do të vendoset në dispozicion të Operatorit Fitues nga ana e Drejtorisë së Përgjithëshme "Posta Shqiptare" në momentin e përshtatshëm për prodhimin e emisioneve të pullave postare, por jo më vonë se **3 (tre)** ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës me procesverbal të nënshkruar nga përfaqësuesit e të dy palëve.

2.3 Kriteri i vlerësimit

Oferta me çmimin më të ulët do të shpallet fituese.

2.4 Afati i zbatimit të kontratës:

1. Malli do të dorëzohet jo më vonë se **80 (tetëdhjetë)** ditë kalendarik nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.
2. Kontrata do të hyjë në fuqi pas miratimit të provokopjes së pullës me përfaqësues të autorizuar nga Drejtoria Përgjithëshme "Posta Shqiptare" SH.A., (jo më vonë se **10 (dhjetë)** ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës). Në se provokopja nuk miratohet brenda këtij afati të caktuar, afatet e kontratës fillojnë **10 (dhjetë)** ditë pas nënshkrimit të kontratës mes palëve.

2.5 Afati përfundimtar për paraqitjen e ofertave do të jetë data **25.05.2026 ora **10:00**.**

Ofertat do të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë zyrës së protokollit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Postës Shqiptare sh.a. brenda afatit të përcaktuar.

Ofertat e dorëzuara mbas orës 10:00 të datës 25.05.2026 do të refuzohen.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.